

TRYEZË E RRUMBULLAKËT

Forcimi i Raportimit Financiar të Korporatave në Kosovë dhe Vendosija e Kërkesave të Raportimit për Qëndrueshmërinë

4 korrik 2023, Prishtinë, Kosovë

CFRR»

**Centre for Financial
Reporting Reform**



Qendra për Reformë të Raportimit Financiar (CFRR),
Praktika Globale e Qeverisjes,
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore, Banka Botërore
Adresa: Praterstrasse 31, 1020 Vienna, Austria
Ueb: www.worldbank.org/cfrr
Email: cfrr@worldbank.org
Telefon: +43-1-217-0700

TRYEZË E RRUMBULLAKËT

Forcimi i Raportimit Financiar të Korporatave në Kosovë dhe Vendosja e Kërkesave të Raportimit për Qëndrueshmërinë

4 korrik 2023, Prishtinë, Kosovë
Swiss Diamond Hotel, Prishtinë (Sheshi Nëna Terezë Nr. 3)
Salla Diamond Club

PARATHËNIE

Programi Rruga drejt Evropës për Reformën e Kontabilitetit dhe Forcimin Institucional për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (REPARIS për NVM) synon të mbështesë: (i) përmirësimin e mëtejshëm të qasjes së NVM-ve në Ballkanin Perëndimor në shërbime profesionale të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar, dhe (ii) përafrimin e kornizave për raportim financiar të korporatave të Ballkanit Perëndimor me direktivat dhe rregulloret relevante të Bashkimit Evropian (BE). Përfituesit e programit janë Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

REPARIS për NVM mbështetet në progresin e arritur në kuadër të programit të realizuar EU-REPARIS (2015-2019). Ai realizohet nga **Qendra e Bankës Botërore për Reformë të Raportimit Financiar (CFRR)**, (CFRR) me seli në Vjenë, Austri, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat e Vendit të Bankës Botërore në vendet përfutuese. Aktivitetet e programit përfshijnë trajnime, evente për mësimnxënie dhe asistencë teknike të ofruar për zyrtarët publikë, rregullatorët, kontabilistët, auditorët, organizatat profesionale të kontabilitetit, organizatat mbështetëse të biznesit dhe odat ekonomike. Komponentët kryesorë të programit janë:

- (A) Mbështetja e zhvillimit dhe zbatimit të programeve për edukim dhe trajnim të qëndrueshëm.
- (B) Mbështetja e transpozimit dhe përafrimit të kornizës ligjore kombëtare dhe praktikave për raportim financiar dhe auditim me kërkesat e BE-së.
- (C) Inkurajimi i qasjes rajonale për zbatimin e reformave të përfunduara të kontabilitetit dhe auditimit.
- (D) Vlerësimet e peizazhit të shërbimeve këshillimore të kontabilitetit dhe Raportet e Kontabilitetit dhe Auditimit për Respektimin e Standardeve dhe Kodeve (A&A ROSCs).

Në kuadër të komponentit (B), REPARIS për NVM ofron asistencë teknike të targetuar për zbatimin e *acquis communautaire* të BE-së. Kjo mbështet transpozimin dhe përafrimin e

kornizës ligjore kombëtare dhe praktikave për raportim financiar dhe auditim me kërkesat e BE-së.

Një gjetje kyçe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022,¹ është se Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim është zbatuar vetëm pjesërisht dhe se kërkohet përafrim i mëtejshëm me *acquis* të BE-së, duke përfshirë raportimin jo-financiar (d.m.th., raportimin e qëndrueshmërisë Kërkesat).

Raporti rekomandon që vitin e ardhshëm, Kosova do të duhej të bëjë përafrimin e mëtejshëm me *acquis* për kontabilitetin e korporatave dhe auditimin ligjor, dhe të forcojë strukturat e mbikëqyrjes së auditimit institucional dhe pavarësinë dhe objektivitetin profesional të auditorëve dhe firmave të auditimit. Kosova duhet të sigurojë fonde të mjaftueshme që Bordi Mbikëqyrës i Auditimit Publik të funksionojë si autoritet kompetent për mbikëqyrjen në këtë sektor, pa asnjë ndikim të padrejtë nga auditorët ligjorë ose firmat e auditimit.

Kjo tryezë e rrumbullakët, e organizuar në bashkëpunim me Këshillin Kosovar për Raportim Financiar dhe Bordin Mbikëqyrës të Auditimit Publik, do të diskutojë fushat kyçe që janë pjesë e procesit për përmirësimin e përafrimit me *acquis* të BE-së në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, si dhe do të konsiderohen aranzhime të ndryshme të mundshme të financimit për sistemin e mbikëqyrjes publike.

Gjuha e eventit është anglishtja me përkthim simultan në shqip.

¹ <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>

AGJENDA | E MARTË, 4 KORRIK, 2023 | 12:30 - 17:00

12:30 Kafja e mirëseardhjes

Fjalët e mirëseardhjes

13:00

Elene Imnadze | Zyrtare e Lartë për Operacione, Banka Botërore
Blirind Danjoli | Këshilltar Politik i Ministrit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Përmirësimi i përafrimit të legjislacionit për auditim dhe kontabilitetit me të BE-së

13:30

Ky sesion do të paraqesë çështjet kyçe dhe hendekët në legjislacionin kombëtar krahasuar me *acquis* të BE-së në fushën e kontabilitetit dhe auditimit (bazuar në draft Tabelat e Transpozimit). Ai gjithashtu do të ofrojë shembuj të aranzhimeve të financimit për sistemin e mbikëqyrjes publike bazuar në praktikën e mirë ndërkombëtare, si dhe do të nxjerrë në pah detyrat dhe kushtet për delegimin e detyrave nga një autoritet kompetent tek një shoqatë profesionale e kontabilitetit.

Prezantimi do të ndiqet nga diskutimi në panel dhe sesioni pyetje-përgjigje.

Andrei Busuioc | Specialist i Lartë për Menaxhim Financiar, Banka Botërore
Svetlana Platon | Konsulente për Menaxhim Financiar, Banka Botërore

14:30

Pauzë për kafe

Diskutim në panel - rruga përpara

15:00

Paneli do të diskutojë ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit aktual për kontabilitet dhe auditim në Kosovë për ta përafruar më mirë me kërkesat e BE-së, duke përfshirë ndikimet e mundshme dhe sfidat e ndërlidhura. Temat do të përfshijnë: (i) transpozimin e kërkesave të raportimit për qëndrueshmërinë; (ii) sigurimin e fondeve të mjaftueshme për ta bërë BMAP-në plotësisht funksional; dhe (iii) rolin e shoqatave profesionale të kontabilitetit në mbikëqyrjen publike dhe sistemet e sigurimit të cilësisë.

Panelistë:

Sokol Shasivari | u.d. Kryesues i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar (KKRF)
Faton Ahmetaj | Kryesues i Bordit Mbikëqyrës të Auditimit Publik

Edona Perjuci | Profesor Asistent dhe Sekretar i Departamenti të Kontabilitetit në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Nazmi Pllana | Kryesues i Bordit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Sylejman Maqastena | Anëtar i Bordit të Institutit AAB për Kontabilistë dhe Auditorë të Certifikuar

Imri Semetishti | Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa

Moderator:

Andrei Busuioc | Specialist i Lartë për Menaxhim Financiar, Banka Botërore

Përmbledhje dhe fjalët e mbylljes

16:30

Sokol Shasivari | u.d. Kryesues i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar (KKRF)

Andrei Busuioc | Specialist i Lartë për Menaxhim Financiar, Banka Botërore

17:00

Fundi i tryezës së rumbullakët

